



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 219, datë 28.12.2017**

**PËR**

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME TË RREGULLORES SË BURSËS SHQIPTARE TË  
TITUJVE (ALSE)**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**K O N S T A T O I S E:**

Me vendimin nr. 89, datë 03.07.2017, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare miratoi statutin e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Titujve ALSE” sh.a. dhe rregulloren e veprimtarisë së Bursës shqiptare.

Shoqëria “Bursa Shqiptare e Titujve ALSE” sh.a., me shkresën nr. 3235 datë 17.11.2017, ka paraqitur dhe depozituar pranë Autoritetit kërkesën për miratimin e ndryshimeve të Rregullores së Bursës Shqiptare të Titujve ALSE, si dhe Komisionet dhe Tarifat që do aplikojë, në mbështetje të vendimeve nr. 2 dhe nr. 3, datë 07.11.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bursës.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e ndryshimeve të Rregullores së Bursës Shqiptare të Titujve (ALSE), si dhe Komisioneve dhe Tarifave të ALSE, sipas materialit bashkëlidhur.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Ervin KOÇI**